



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 409/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.06.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë “Adenis Kastrati” shpk dhe “Euro Office” shpk në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me nr. REF-13192-03-12-2019, me objekt “*Blerje bojra printeri dhe fotokopje*” me fond limit 5,283,510 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 25.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Ankimues: “Erisoni Company” shpk
Durrës

Autoriteti kontraktor: Bashkia Fier
Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi

Person i Interesuar: Adenis Kastrati P.F
Lagjia Nr.4, Rruga Demokracia, Godina Nr.29, Kati 1
Bathore, Kamëz

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.03.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me nr. REF-13192-03-12-2019, me objekt “*Blerje bojra printeri dhe fotokopje*” me fond limit 5,283,510 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 25.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

II.2. Në datën 25.03.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 15.05.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- Infosoft Office	2,500,407.23	I skualifikuar
- IT Gjergji Kompjuter	3,155,739.33	I skualifikuar
- Adenis Kastrati	3,388,900	I kualifikuar
- Erisoni Company	3,536,000	I kualifikuar
- Euro Office	4,141,450	I kualifikuar
- Sajmir Mema	4,608,957	I kualifikuar
- Adastra	4,678,000	I kualifikuar
- PC Store	4,953,812.5	I kualifikuar
- Blueprint Technologies	—	I skualifikuar

II.4. Në datën 17.05.2019 operatori ekonomik ankimues “Erisoni Company” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Së pari KVO ka kualifikuar në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DT OE **ADENIS KASTRATI** pasi ky OE nuk ka paraqitur dokumentacion i cili provon se ka realizuar furnizime të ngjashme në masën 2,000,000 lekë.*
- *Së dyti KVO ka kualifikuar në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DT pasi OE Adenis Kastrati nuk ka paraqitur një vërtetim i cili provon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për kontratat e energjisë që ka OE. Duke patur në konsideratë faktin se tenderi është zhvilluar në datën 25.03.2019 operatori ekonomik duhet të paraqiste një vërtetim lëshuar nga OSHEE sha në të cilin të vërtetohej pagesa e muajit Janar 2019 vërtetimi i paraqitur nga Adenis Kastrati nuk provon likuidimin e pagesës së muajit Janar 2019.*
- *Së treti Adenis Kastrati nuk ka paraqitur shtojcën 2/1 Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur ose në rast paraqitje nuk e ka plotësuar atë ashtu sikurse kërkohet në pikën 6/a ose 6/b të formularit. Pra OE nuk ka deklaruar sipas pikës 6 të shtojcës 2/1 se: ka përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur pa u konsultuar , komunikuar dhe pa bërë marrëveshje me një operator tjetër apo është konsultuar me ndonjë operator tjetër për plotësimin e ofertës.*
- *Së katërti Adenis Kastrati nuk ka paraqitur Deklaratën për Përbushjen e Kritereve të Përgjithshme shtojca 5 ose në rast të paraqitjes së saj OE nuk e ka plotësuar atë në mënyrën e kërkuar duke mos përcaktuar dhe përmendur emrat e administratorit, ortakut apo ortakëve dhe përfaqësuesve të cilët kanë kompetenca vendim marrëse dhe kontrolluese brenda OE.*

- Së pesti ky OE nuk ka paraqitur akreditimin e ISO 9001:2015

II

- Së pari KVO ka kualifikuar në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DT operatorin ekonomik **EURO OFFICE** pasi ky OE nuk plotëson këkesën e përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik të DT , nuk ka paraqitur furnizime të ngjashme në masën 2,000,000 lekë pa tvsh të realizuara gjatë 3 viteve të fundit. Furnizimet e ngjashme për të përmbushur kriterin ky subjekt i ka për furnizim me kancelari dhe jo tonera për printera dhe fotokopje sikurse është dhe objekti i prokurimit.
- Së dyti Euro Office nuk ka paraqitur fare shtojcën 2/1 Deklartatë për ofertë të pavarur ose në rast paraqitje nuk e ka plotësuar atë ashtu sikurse kërkohet në pikën 6/a ose 6/b të formularit.
- Së treti Euro Office nuk e ka paraqitur ISO 9001:2015. Edhe nëse e ka paraqitur Ison ne e dimë me siguri që ky operator nuk është i certifikuar me ISO 9011:2015. Me siguri do të ketë paraqitur ISO të ndonjë prodhuesi ose furnitori e cila nuk ka lidhje me tenderin dhe është në kundërshtim me RRPP.

Sa më sipër kërkojmë skualifikimin e ofertave të OE Adenis Kastrati dhe Euro Office shpk.

II.5. Me shkresën nr.4519/4 prot datë 20.05.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje OE ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.6. Në datën 27.05.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.4966/1 prot datë 03.06.2019 protokolluar me tonën me nr.941/2 prot datë 07.06.2019 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes "Erisoni Company" shpk për skualifikimin e operatorit ekonomik "Adenis Kastrati" me argumentat se "Adenis Kastrati nuk ka paraqitur shtojcën 2/1 Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur ose në rast paraqitje nuk e ka plotësuar atë ashtu sikurse kërkohet në pikën 6/a ose 6/b të formularit. Pra OE nuk ka deklaruar sipas pikës 6 të shtojcës 2/1 se: ka përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur pa u konsultuar , komunikuar dhe pa bërë marrëveshje me një opertor tjetër apo është konsultuar me ndonjë operator tjetër për plotësimin e ofertës", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 2/1 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Shtojca 2/1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

DEKLARATË

Për paraqitje Oferte të Pavarur

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë: _____; nga Autoriteti Kontraktor: _____; me objekt: _____; me fond limit: _____.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik _____, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

Unë vërtetoj, në interes të: _____ që:
(Emri i operatorit ekonomik)

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimet publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;

4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
- a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues potencial, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër; ☐
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit). ☐
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

(Emri dhe Firma e Personit të Autorizuar për Përfaqësim të Ofertuesit)

(Titulli sipas pozicionit në punë) (Data)

III.1.2. Në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);*
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;*
- c. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;*
- ç. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Adenis Kastrati” P.F nuk ka dorëzuar shtojcën 2/1 Deklaratë për Ofertë të pavarur të kërkuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Adenis Kastrati” P.F nuk plotëson kriterin e vecantë të kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur shtojcën 2/1 “Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur” pjesë e dokumentave të tenderit. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të

gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumentave të tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: *“Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”; “Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”,* KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues *“Adenis Kastrati ”* shpk shpk duhe të kishte paraqitur shtojcën 2/1 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues *“Erisoni Company”* shpk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues *“Erisoni Company”* sh.p.k. mbi kualifikimin e shoqërisë *“Adenis Kastrati”* P.F, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjykimit mësipër gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik *“Adenis Kastrati”* P.F. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimesit.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik *“Erisoni Company”* shpk mbi kualifikimin e shoqërisë *“Euro Office”* sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit për të cilin paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët e renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Erisoni Company” shpk për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me nr. REF-13192-03-12-2019, me objekt “*Blerje bojra printeri dhe fotokopje*” me fond limit 5,283,510 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 25.03.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Adenis Kastrati” P.F duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Erisoni Company” shpk
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.941 Protokolli; Datë 27.05.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha